

## ANEKSI 6

### Fondi për menaxhimin e fatkeqësive natyrore

1. Fondi për **Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore** është një mekanizëm financiar që mbështet politikën kombëtare të parandalimit dhe menaxhimit rajonal dhe vendor të fatkeqësive natyrore.
  2. Për vitin 2022, Fondi për **Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore** përbëhet nga fondi i akorduar në buxhetin e vitit 2022 në programin “Emergjenca Civile”, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.
  3. Shpërndarja e Fondit për **Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore** sipas projekteve kryhet nga Komiteti për **Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore**, i cili kryesohet nga Zëvendëskryeministri dhe ka këtë përbërje:
    1. Zëvendëskryeministri Kryetar;
    2. Ministri i Mbrojtjes Zëvendëskryetar;
    3. Ministri i Financave dhe Ekonomisë anëtar;
    4. Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural anëtar;
    5. Ministri i Brendshëm anëtar;
    6. Zëvendës Ministri i Mbrojtjes anëtar;
    7. Ministri i Turizmit dhe Mjedisit anëtar;
    8. Ministria e Infrastrukturë dhe Energjisë anëtar;
    9. Drejtori i AKMC anëtar;
    10. Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë anëtar;
    11. Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore anëtar;
    12. Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë anëtar;
- Në mungesë të kryetarit të Komitetit, mbledhja drejtohet nga zëvendëskryetari.
4. Komiteti për **Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore** miraton:
    - a) Specifikimet, rregullat dhe kriteret për financimin e projekteve dhe ndarjen e fondit;
  5. Fondi i **Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore** me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, në përputhje me ecurinë e projektit. Ministria e Mbrojtjes mund të kërkojë rialokime midis projekteve të Fondit të **Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore**, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.
  6. Thirrjet për aplikim në Fondin e **Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore** për vitin buxhetor mund të bëhen që në Nëntor të vitit paraardhës.
  7. Fondi i **Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore** nuk trashëgohet në vitin e ardhshëm, buxhetor.
  8. Sekretariati teknik për Fondin e **Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore** ngrihet pranë Ministrinë së Mbrojtjes. Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për **Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore** është një njësi pranë AKMC.
  9. Subjektet aplikuese dhe zbatuese janë njësitë e vetëqeverisjes vendore. Komiteti miraton me vendim autoritetin kontraktor për zbatimin e projektit. Rregulla të hollësishme lidhur me raportimin e autoriteteve kontraktuese miratohen me vendim të Komitetit për **Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore**.
  10. Rregulla të hollësishme lidhur me funksionimin e të gjithë procesit të programimit, monitorimit dhe raportimit të ecurisë së zbatimit miratohen me vendim të Komitetit të Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore.